1809

Gmail

Res Publica <qendra.respublica@gmail.com>

50/1

# [347157]Pergjigje-Kthim përgjigje

**Zyraebashkeqeverisjes** <zyraebashkeqeverisjes@shqiperiaqeduam.al>
To: "qendra.respublica@gmail.com" <qendra.respublica@gmail.com>

Thu, May 27, 2021 at 2:41 PM

**Përshëndetje Dorian Matlija Res Publica ,**

Përgjigje ndaj kërkesës tuaj me Numër:347157

Përshëndetje, Duke ju falenderuar që jeni bërë pjesë e Platformës së Bashkëqeverisjes, lutemi gjeni si më poshtë përgjigjen zyrtare nga Ministria e Shtetit për Rindërtim: "Në përgjigje kërkesës tuaj për informacion Nr. Prot 1056 KM, datë 19.05.2021 ku kërkohet informacion në lidhje me: - Sa është numri i ndërtesave të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 (të ndara sipas llojit psh: banesa private, pallate, biznese, institucione, shkolla, objekte kulturore etj) Raporti i PDNA
–së i realizuar nga grupi i përbashkët i punës i Bankës Botërore, Kombeve të Bashkuara dhe Komisionit Europian, të cilët kanë berë edhe vlerësimin e dëmeve për cdo sektor dhe pasqyruar ne raportin e PDNA. Raporti i PDNA është publikuar në fillim të vitit 2020,
i cili është publik dhe i aksesueshëm online dhe ku mund të gjeni detaje të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019, sipas pyetjes tuaj. Sipas vleresimit paraprak, vlera e demeve sipas PDNA eshte perllogaritur 1.15 miliardë euro. - Sa prej
tyre janë vlerësuar si të banueshme dhe është përcaktuar vlera e rikonstruksionit dhe sa prej tyre është vendosur shembja dhe ndërtimi rishtas? Informacion me te detajuar ne lidhje me kete pyetje mund te gjendet prane Institutit te Ndertimit Tirane. - Sa është
vlera totale e rikonstruksioneve për të gjitha ndërtesat e dëmtuara? Komisioni Shteteror i Rindertimit ka aprovuar sipas vleresimit te thelluar te Institutit te Ndertimit dhe sipas kerkesave te Bashkive te prekura, ka aprovuar grantet e rikonstruksionit DS1
- DS3 ne total per 4500 banesa individuale, 1100 apartamente, nga te dhenat deri ne daten 15.04.2021. Nga te dhenat deri ne date 15.04.2021 është alokuar fondi prej 18,65 mld - Grantet e rikonstruksionit/rindërtimit (alokimi i fondit bashkë me ambientet e
përbashkëta) Për sa më lart, duhet të merrni në konsideratë që procesi i rindërtimit nuk është financuar vetëm nga buxheti i shtetit, por edhe nga donatorët." Me konsideratë, Zyra e Bashkëqeverisjes Rrjeti i koordinatorëve të biznesit

*Faleminderit,*

Ju lutemi, nëse i përgjigjeni ketij emaili mos ndryshoni Subjektin e tij pasi shërben si numër identifikues i ankesës tuaj!
Ju falemindenit për mirëkuptimin!

Informacioni i trasmetuar në permbajtje te ketij mesazhi është i destinuar vetem për individin ose për institucionin të cilit i eshte nisur, mund të permbaje materiale konfidenciale dhe / ose te privilegjuara vetëm për marresin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me keto, nga personat apo nga subjekte te tjera të ndryshme nga marresi i synuar,eshte i ndaluar. Nese merrni gabimisht kete mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dorguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar ne kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojme asnje detyrim lidhur me demtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe te demshme apo nga viruse ; perveç rastit te neglizhences së plote, apo sjelljes se gabuar dhe të qëllimshme.